



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 9, datë 12.07.2019

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:

“NDËRTIMI I GODINËS SË RE TË MATERNITETIT 4 KATE MBITOKË DHE 1 KAT  
NËNTOKË, RIKONSTRUKSION I SPITALIT KRYESOR DHE POLIKLINIKËS”,  
BRENDA TERRITORIT TË SPITALIT RAJONAL LEZHË”


Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Lezhë, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Lejes së Ndërtimit për objektin: “Ndërtimi i godinës së re të maternitetit 4 kate mbitokë dhe 1 kat nëntokë, rikonstruksion i spitalit kryesor dhe Poliklinikës”, brenda territorit të Spitalit Rajonal Lezhë”, me zhvillues Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Lezhë.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Lezhë.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI


EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

OGERTA MANASTIRLIU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

